

Course Name : E Drejtë Civile II							
Course Code	Course Type	Regular Semester	Lecture (hours/week)	Seminar (hours/week)	Lab. (hours/week)	Credits	ECTS
LAW 226	N/A	Spring	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lecturer		Fatri Islamaj, PhD					
Assistant		Erisa Datja, MSc					
Course language		Albanian					
Course level		Program i Integruar					
Description		E drejta civile është një nga disiplinat e formimit karakterizues dhe profesional të programit të studimeve të nivelit të parë. Ky kurs është pjesë e dytë e cila ka për qëllim të familjarizojë studentët me konceptet e bashkepronësive, të drejtën e parablerjes, uzufuktin, servitutit, mbrojtjen e të drejtës së pronësive. Në këtë lëndë do të trajtohet edhe koncepti i trashëgimit, si trashëgimia me ligj, me testament dhe padite perkatese. Lënda do të ketë të integruar dhe diskutime dhe debate në klasë lidhur me temat specifike kontemporane të lidhura me të drejtën civile.					
Objectives							
Core Concepts		1. Pronesi 2. Uzufukt 3. Servituti 4. Trashëgimi					
Course Outline							
Week	Topic						
1	Marrëdhëniajuridike e pronësisë Hyrje e përgjithshme në marrëdhënien juridike të pronësisë duke shpjeguar se çfarë është ajo dhe duke përcaktuar elementët e saj. Ndalet në shpjegimin e llojeve të sendeve të cilët janë objekt pronësie. Po ashtu, përcaktohen subjektet të cilët mund të kenë në pronësi sende të caktuara. Libri: Ardian Nuni & Luan Hasneziri, E Drejta Civile II : Pronësia (Tiranë 2010) (Fq.5-93)						
2	Bashkëpronësia Ky leksion trajton marrëdhënien e bashkëpronësisë dhe përcakton llojet e saj duke patur parasysh si lind bashkëpronësia, të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve si dhe procedurat e ndjekura për pjesëtimin e sendit objekt bashkëpronësie. (Fq. 156-222)						
3	Fitimi dhe humbja e pronësisë Në këtë leksion shqyrton mënyrat e fitimit të pronësisë të cilat janë mënyra origjinale dhe të prejardhura. Të gjitha këto mënyra sqarohen në mënyrë të detajuar. Gjithashtu, një vëmendje e vecantë i kushtohet mbarimit të së drejtës së pronësisë duke sqaruar edhe pasojat që kanë për pronarët e sendeve. (Fq. 94-155)						
4	Posedimi Posedimi trajtohet në mënyrë të vecantë si një nga të drejtat e përfshira në ushtrimin e pronësisë nga ana e pronarit. Bëhen të qarta dy situatat ku e drejta e posedimit mund t'i takojë pronarit të sendit ose një personi tjetër të cilit pronari i ka kaluar të drejtën e posedimit mbi sendin. Bëhet shpjegimi se çfarë përmbaj e drejta e posedimit, si lind ajo dhe kur mbaron kjo e drejtë për subjektët. (Fq. 520-556)						
5	Mbrojtja e pronësisë Në këtë leksion trajtohen mënyrat e mbrojtjes së pronësisë duke sqaruar të gjitha llojet e padive nëpërmjet të cilave subjektet mund t'i drejtohen gjykatës për mbrojtjen e pronësisë së tyre. Këtu mund të përmendim padinë e rivendikimit, padinë mohuese, padinë e saktësisë dhe të rregullimit të kufijve, padinë e kallzimit të një dëmi të mundshëm etj. Të gjitha këto padi analizohen duke përcaktuar kushtet e ngritjes së padisë, legjitimitimin aktiv dhe pasiv të subjekteve, afatet dhe mundësinë e parashkrimit të padive. (Fq. 420-519)						
6	Uzufukti - Kuptimi, mënyrat e krijimit, afati dhe objekti i uzufuktit - Bashkëuzufukti Kjo temë trajton institutin e uzufuktit duke dhënë përkufizimin, mënyrën sesi krijohet uzufukti, si dhe sendet të cilat mund të vendosen në uzufukt. Gjithashtu trajtohet edhe bashkëuzufukti. (Fq. 227-241)						

7	Uzufukti vazhdim Kjo temë trajton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga uzufukti për uzufuktuesin dhe pronarin e sendit objekt uzufukti. Krahas kësaj jepen udhëzimet se si mund të mbarojë uzufukti duke përcaktuar mënyrat e shuarjes së tij dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga dispozitat ligjore. (Fq. 242-304)
8	Provim Gjysmë-final
9	Servitutet Në këtë leksion jepet përkufizimi i servitutit, si një koncept shumë i rëndësishëm dhe i aplikueshëm në marrëdhëniet e bashkëqinjësisë. Po ashtu, përcaktohen llojet e servituteve duke përfshirë servitutet e qytetit dhe servitutet e fshatit. (Fq. 305-385)
10	Servitutet vazhdim Në këtë leksion përcaktohen mënyrat sesi mund të bëhet ushtirimi i servituteve si dhe përcaktohen momentet e shuarjes së servituteve. Një vëmendje e vecantë i kushtohet mbrojtjes së sëervituteve pra përcaktimit të mënyrave sesi subjektet fqinje mund t'i drejtohen gjykatës për mbrojtjen e servituteve. (Fq. 386-419)
11	Kuptimi i trashëgimisë, përmbajtja dhe karakteristikat e saj Ky leksion jep kuptimin dhe rëndësinë e trashëgimisë duke sqaruar vecanërisht karakteristikat, kohën dhe vendin e celjes së trashëgimisë. Gjithashtu trajtohet objekti i trashëgimisë si dhe mënyra si mund të bëhet heqja dorë nga trashëgimia. Libri: Ardian Nuni & Luan Hasneziri, E Drejta Civile III : Trashëgimia (Tiranë 2010) (Fq. 7-55)
12	Trashëgimia ligjore Në këtë leksion shpjegohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë dhe mënyra sesi bëhet thirrja në trashëgimi e këtyre trashëgimtarëve. Po ashtu jepen karakteristikat e saj dhe përcaktohet mënyra sesi rregullohet trashëgimia me zëvendësim dhe e drejta e shtimit. (Fq. 56-82)
13	Trashëgimia testamentare Në këtë leksion jepet kuptimi i testamentit dhe karakteristikat e tij. Gjithashtu trajtohen subjektet të cilët e kanë zotësinë për të disponuar me testament dhe të për të fituar me testament. Krahas këtyre, analizohet forma, përmbajtja e testamentit dhe rezerva ligjore. Në përfundim, bëhet shpjegimi i pavlefshmërisë së testamentit, përfshirë pavlefshmërinë absolute dhe relative. (Fq. 83-166)
14	Paditë në lidhje me trashëgiminë Leksioni trajton mënyrat sesi mbrohet trashëgimia duke përcaktuar edhe paditë me anë të të cilave trashëgimtari mund t'i drejtohet trashëgimtari. Kështu, sqarohet dëshmia e trashëgimisë, padia për kërkimin e trashëgimit, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore dhe masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore. (Fq. 167-210)
15	Review
16	Final Exam
Prerequisites	
The student must attend the course at a minimum rate of 75%.	
Literature	
<ul style="list-style-type: none"> • 1. Ardian Nuni & Luan Hasneziri, E Drejta Civile II : Pronësia (Tiranë 2010) • 2. Ardian Nuni & Luan Hasneziri, Leksione të së drejtës së pronësisë (Tiranë 2006) • 3. Nuni, Ardian. Hasneziri, Luan. Leksione të së drejtës së trashëgimisë, (Tiranë 2006) 	
References	
<ul style="list-style-type: none"> • 5. Avni Shehu, E drejta e Pronësisë (Biblioteka e Fakultetit te Drejtësisë) • 2. Francesco Galgago, E drejta private (Tiranë: Biblioteka e Fakultetit te Drejtësisë 2001) 	
Course Outcome	
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi te drejten e pronësisë, mënyrat e fitimit dhe mbrojtjen e saj.
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi uzufuktin.
3	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi servitutit.
4	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi te drejten e trashëgimisë.

Course Evaluation			
In-term Studies	Quantity	Percentage	
Midterms	1	40	
Quizzes	0	0	
Projects	0	0	
Term Projects	0	0	
Laboratory	0	0	
Class Participation	0	0	
Total in-term evaluation percent		40	
Final exam percent		60	
Total		100	
ECTS Workload (Based on Student Workload)			
Activities	Quantity	Duration (hours)	Total (hours)
Course duration (Including the exam week: 16x Total hours of the course)	16	4	64
Study hours outside the classroom (Preparation, Practice, etc.)	14	4	56
Duties	0	0	0
Midterms	1	10	10
Final Exam	1	20	20
Other	0	0	0
Total Work Load			150
Total Work Load / 25 (hours)			6.00
ECTS			6.00